



Plani Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë

2022-2024



“Integriteti, transparenca dhe lufta kundër korrupsionit duhet të jenë pjesë e kulturës. Ato duhet të mendohen si vlera themelore.”

— Angel Gurria, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)

HYRJE

Në vitin 2016, Shqipëria miratoi reforma kushtetuese dhe legislative gjithëpërfshirëse, me qëllim forcimin e integritetit dhe qeverisjes së gjyqësorit në vend. Këto reforma përcaktuan edhe ngritjen e institucioneve të reja, përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi vetëqeverisës i gjyqësorit në Shqipëri, i cili u krijua në dhjetor të vitit 2018. Mes funksioneve të shumta, Këshillit i kërkohet të bëjë planifikimin strategjik, në emër të të gjithë gjyqësorit.

Plani i parë strategjik u hartua në vitin 2019 nga KLGJ-ja, në këshillim me një gamë të gjerë palësh interesi duke përfshirë kryetarët e gjykatave, shoqërinë civile dhe Ministrinë e Drejtësisë (MD). Plani i përditësuar është produkt i konsultimeve të gjera dhe është në harmoni të plotë me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SNSD) dhe legjislacionin shqiptar.

Anëtarët e KLGJ-së kanë përgjegjësi të plotë për përcaktimin e qëllimit të vënë në këtë plan, vendosjen e prioriteteve të duhura, dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për përmbushjen e vizionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dëshiron të shprehë një falënderim të veçantë për Ministrinë e Drejtësisë dhe ekipin e saj, të cilët kanë punuar në konsultim të ngushtë me Këshillin për t'u siguruar që Plani Strategjik të ishte në përputhje të plotë me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe prioritetet e tjera të ministrisë.

SFONDI

KLGJ-ja ishte një nga institucionet e para të sistemit të drejtësisë që u krijua përmes kornizës së reformës në drejtësi. Pak kohë pas themelimit të saj, KLGJ-ja hartoi dhe miratoi një Plan Strategjik dyvjeçar, të shoqëruar dhe me një Plan Veprimi. Plani Strategjik u hartua përgjatë seancave të gjata, por edhe të suksesshme, gjatë të cilave anëtarët e KLGJ-së propozuan dhe diskutuan ide të ndryshme, të mbështetur nga administrata dhe asistencë teknike ndërkombëtare. Rezultati ishte një plan strategjik që:

- përcaktoi misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike që do të drejtonin veprimtarinë e KLGJ-së përgjatë viteve të ardhshme;
- identifikoi dhe pasqyroi nevojat e KLGJ-së, si një institucion i ri dhe nevojat e gjyqësorit në tërësi;
- ndihmoi në përmbushjen e mëtejshme të synimeve të reformës në drejtësi; dhe
- dha një orientim për komunitetin ndërkombëtar të donatorëve në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes së tyre.

Plani Strategjik i KLGJ-së pajtohej dhe lidhej me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 (SNSD). KLGJ-ja ishte përgjegjëse për zbatimin e atyre komponentëve të strategjisë që kishin të bënin me forcimin e pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor, përfshirë përmirësimin e statusit të gjyqtarëve, rritjen e aksesit në drejtësi, përmirësimin e infrastrukturës së sistemit gjyqësor dhe sigurimin e një sistemi të duhur të menaxhimit të çështjeve për gjykatat.

Plani Strategjik i KLGJ-së ishte i lidhur edhe me prioritetet e politikave kombëtare, siç përshkruhen në dokumente të ndryshme strategjish e politikash. Ai adresoi objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, që synojnë “ndërtimin e një vendi bazuar në shtetin e së drejtës dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me një sistem drejtësie të hapur dhe të barabartë”, si dhe objektivat e Planit Kombëtar Shqiptar për Integrimin Evropian 2017-2020, që synonin ngritjen e “një sistemi drejtësie të pavarur, llogaridhënës dhe efikas në Shqipëri, i cili është në gjendje të bëjë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente”. Po ashtu, ai adresoi mangësitë e vëna në dukje nga Raportet e fundit të Komisionit Evropian për Progresin e Shqipërisë, në lidhje me krijimin e institucioneve të reja e të pavarura gjyqësore dhe ndjekjen e një qasjeje sektoriale ndaj reformës në drejtësi, në kuadrin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën 2017-2020.

Raportet e monitorimit dhe vlerësimit, të përcaktuara nga Plani Strategjik, ndihmojnë për të siguruar një zbatim të efektshëm të synimeve e objektivave të identifikuara. Gjatë dy viteve të para, KLGJ-ja e shpenzoi shumicën e energjive dhe burimeve të saj me adresimin e nevojave emergjente të sistemit gjyqësor, të cilat kishin të bënin kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore në gjykata dhe me mungesën e plotë të legjislacionit dytësor. Edhe pse KLGJ-ja ka qenë e frytshme në veprimtarinë e saj legjislative, disa aktivitete të tjera nuk u arritën të zbatoheshin për shkak të faktorëve që ishin jashtë kontrollit dhe ndikimit të KLGJ-së, përfshirë këtu tërmetin dhe pandeminë COVID-19.

PROGRESI I ZHVILLIMIT ORGANIZATIV

Reformimi i një sistemi lidhet drejtpërdrejt edhe me zhvillimin institucional të tij. Gjyqësori në Shqipëri ka formën e një strukture komplekse organizative dhe ky kompleksitet mori një kuptim të ri me paketën e Reformës në Drejtësi të vitit 2016. Ndryshimet në qeverisjen e sistemit gjyqësor, si rrjedhojë e kësaj reforme, krahas krijimit të institucioneve të reja diktuan edhe nevojën për një administrim më aktiv të sistemit në funksion të rritjes së besimit të publikut.

Gjatë dy viteve të para është vënë re se KLGJ-ja ka patur një zhvillim të konsiderueshëm nga pikëpamja institucionale dhe ndonëse janë hedhur themele të forta, ndryshimet rrënjësore që sollin reforma dhe kërkesat e saj nënkuptojnë ndryshime të tjera në vazhdimësi dhe zhvillimin e mëtejshëm të KLGJ-së si organ qeverisës. KLGJ-ja u krijua me një administratë mbështetëse të kufizuar, të cilën e trashëgoi nga KLD-ja dhe ZABGJ-ja. Me qëllim përmbushjen e kompetencave të përcaktuara me ligj, lindi si nevojë një riorganizim dhe zgjerim i kësaj

administratë mbështetëse. KLGJ-ja e ka realizuar me sukses këtë zgjerim, dhe strukturat e mëparshme administrative janë shkruar me institucionin e ri, shoqëruar dhe me risitë që janë bërë në strukturë për përmbushjen e rolit tashmë më të zgjeruar të Këshillit të ri.

Tashmë Njësitë administrative, si ajo e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme, Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve dhe një njësi më e zgjeruar e TI-së dhe menaxhimit të çështjeve janë plotësuar me staf dhe janë funksionale. Struktura organizative e KLGJ-së u zgjerua nga një staf me 71 punonjës, të trashëguar nga struktura e mëparshme, në një strukturë prej 108 punonjësish të rekrutuar deri në fund të 2021, përkundrejt organigramës së miratuar prej 125 punonjësish. Ndërkohë, anëtarët kanë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarive të KLGJ-së dhe gjykatave, gjë e cila do të vazhdojë dhe nuk do të ndryshojë për njëfarë kohe edhe në të ardhmen.

Si një organ qeverisës, KLGJ-ja e konsideron zhvillimin organizativ të saj si një proces të vazhdueshëm i cili vijon përkrah zbatimit të mëtejshëm të reformës në drejtësi, mbështetur mbi themelet e ngritura tashmë. Në rrugëtimin e tyre, KLGJ-ja dhe gjykatat do të mbështeten në këto themele për të adresuar sfidat e shumta që do të hasin. Ndër këto sfida janë procesi i Vetting-ut, pandemia COVID-19 dhe rikuperimi i vazhdueshëm nga tërmeti i nëntorit të 2019-s. Në vitin 2021, Këshilli do të mirëpresë pesë anëtarë të rinj. Ndërsa institucioni do të vazhdojë veprimtaritë e tij, organi kolegjal do të duhet të menaxhojë në mënyrë aktive një ndryshim prej 45% të anëtarësisë së tij. Edhe pse kjo nuk është një detyrë e lehtë, anëtarët që do të mbeten janë përgatitur për këtë ndryshim dhe do t'i mirëpresin anëtarët e rinj duke mundur një proces prezantimi në detyrë që lejon sukses maksimal.

Gjatë periudhës së ardhshme strategjike, gjykatat do të shohin ndryshime të mëdha, dhe KLGJ-ja është e përgatitur për ti adresuar këto ndryshime. Prosesi i Vetting-ut është pasuar me ndryshime në lidhshmëri të këshillave të gjykatave dhe një vëmendje e vazhdueshme do të përqendrohet te nevoja për të garantuar emërimin në kohë të Kryetarëve të Gjykatave. Menaxhimi i çdo ndryshimi që do të vijë si rezultat i zbatimit të Hartës së re Gjyqësore do të kërkojë angazhimin e plotë të anëtarëve të Këshillit, Njësitë Administrative të KLGJ-së dhe vetë gjykatave. Këto struktura janë të përgatitura për një angazhim të tillë. Pandemia e COVID-19 vazhdon të mbetet një sfidë për gjykatat, të cilat përpiqen të gjejnë ekuilibrin e duhur midis sigurimit të shëndetit publik dhe aksesit në drejtësi. KLGJ-ja do të vazhdojë punën e saj me gjykatat dhe institucionet e shëndetit për të garantuar gjetjen e ekuilibrit të duhur.

Si organi qeverisës i një strukture komplekse organizative, KLGJ-ja shfrytëzon këtë mundësi për të vlerësuar punën e vazhdueshme të njësisë së saj administrative, si dhe veprimtarinë e 38 gjykatave dhe kjo në përputhje me vizionin për një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, transparent, llogaridhënës e në shërbim të qytetarëve. Tashmë themelet janë hedhur dhe janë formuar shtigjet e reja në këtë drejtim. Ky vlerësim do të shërbejë në çdo hap për të garantuar realizimin e sfidave të përbashkëta në funksion të përmbushjes sa të detyrimeve kushtetuese, po aq edhe pritshmërive të publikut.

METODOLOGJIA DHE PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Dy vjet pas miratimit të reformave gjyqësore madhore, ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor shënoi një pikë kthese në menaxhimin dhe riorganizimin e përgjithshëm të gjyqësorit të Shqipërisë. Menjëherë pas themelimit, KLGJ-ja nisi punën intensive për të priorizuar veprimtaritë e saj, planifikuar vendimmarrjen, si dhe për të ndërmarrë hapat e duhur lidhur me mirë funksionimin e sistemit gjyqësor. Këshilli e kuptoi urgjencën e atij momenti dhe veproi me shpejtësi e efikasitet për të hartuar dhe miratuar Planin e tij të parë Strategjik, në interes të qytetarëve shqiptarë.

Pranë fundit të vitit të dytë, KLGJ-ja filloi hartimin e këtij Plani të ri Strategjik për të gjithë gjyqësorin. Procesi u parapri nga një punë përgatitore, që konsistoi në vlerësimin e shkallës së zbatimit të planit të parë dhe konsultimin me grupet e interesit, me qëllim identifikimin e fushave ku ka nevojë për ndërhyrje strategjike. Procesi i konsultimit përfshiu takime dhe shkëmbim idesh me përfaqësues të gjyqësorit, Ministrisë së Drejtësisë, shoqërisë civile si dhe për herë të parë, edhe komunitetit të biznesit.

Procesi i hartimit të Planit të ri Strategjik të KLGJ-së ndodhi në të njëjtën kohë me procesin e hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën 2021-2025 (SND II), proces i cili u drejtua nga Ministria e Drejtësisë (MD). SND II u mbështet në plane veprimi të veçanta, që korrespondojnë me objektivat specifike dhe vishnin me përgjegjësi individuale secilin institucion të sistemit të drejtësisë për zbatimin e tyre. KLGJ-ja dhe MD-ja i kanë koordinuar përpjekjet e tyre për të siguruar që të dy dokumentat strategjik të ishin në përputhje dhe të lidhura, për aq sa është e mundur, me njëra-tjetrën.

Me këtë plan të përditësuar trevjeçar (2022 - 2024), Këshilli po përcakton drejtimin strategjik të gjyqësorit për periudhën e ardhshme, duke marrë me kujdes në konsideratë faktorët që mund të ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e përshkruara në këtë strategji.

Përgjatë tre viteve të ardhshme, KLGJ-ja është e angazhuar të forcojë rolin e saj si organi qeverisës dhe udhëheqës i sistemit gjyqësor në Shqipëri. Këshilli do të vazhdojë ta përsosë edhe më shumë fokusin e tij dhe të bëjë zgjedhje strategjike, sa herë që do të bëhet fjalë për të adresuar problemet më të rëndësishme, me të cilat përballlet sistemi gjyqësor në Shqipëri.

Duke e kuptuar qartë këtë rol thelbësor dhe pavarësisht pandemisë, Këshilli u angazhua edhe një herë në një proces dinamik të planifikimit strategjik, për të përcaktuar një të ardhme ku qytetarët, gjyqësori dhe qeveria i koordinojnë përpjekjet e tyre drejt fuqizimit të politikave dhe praktikave gjyqësore të Shqipërisë dhe arritjes së rezultateve që kontribuojnë në vendosjen e besimit të publikut.

Përmes një procesi konsultativ proaktiv online, pjesëmarrësit e ndryshëm nga KLGJ-ja dhe gjykatat përmirësuan analizën SWOT dhe kaskadën e strategjisë, të përshkruara në vijim, si dhe parametrat që i përshtaten mënyrës së vullshme të punës.

KLGG-ja mbështetet në një qasje transparente në punën e saj, duke përfituar nga përvoja mjaft e gjerë e anëtarëve të saj dhe nga konsultimet me palët e interesit. Ajo synon drejt zgjidhjes së problemeve dhe zbatimit të praktikave më efikase gjyqësore ndërkombëtare. Njëkohësisht, KLGG-ja vazhdon të adaptojë me kujdes instrumentet e provuara në vende të tjera për të adresuar çdo problem apo nevojë që shfaqet.

KLGG-ja luan një rol jetik, duke shërbyer si zëri për sundimin e ligjit dhe duke advokuar në çdo shkallë të gjyqësorit për të ndërmarrë reformat e duhura, të cilat udhëhiqen nga vlerat. KLGG-ja është e angazhuar që të punojë në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, Qeverinë e Shqipërisë, partnerët për zhvillim, gjyqtarët dhe natyrisht, qytetarët, për të bërë investime strategjike, të cilat çojnë drejt një sistemi gjyqësor efikas dhe të respektuar.

Gjatë kohës kur po hartohet ky plan, KLGG-ja ka diskutuar dhe debatuar një sërë çështjesh kontekstuale dhe sfidash aktuale të cilat duhet të përcaktojnë prioritetet e planit, mes të cilave përfshihen:

- a) **reputacioni historik i gjyqësorit dhe perceptimin e publikut;**
- b) **stoku prej 35.000 çështjesh të prapambetura në Gjykatë të Lartë dhe procesi i emërimit të 9 gjyqtarëve të tjerë në këtë Gjykatë;**
- c) **ritmi i ndryshimeve teknologjike dhe impakti i tyre mbi funksionimin e gjyqësorit;**
- d) **kufizimet e buxhetit dhe nevojat infrastrukturore;**
- e) **mungesa serioze me personel në gjykata;**
- f) **burimet e disponueshme të financimit për sistemin gjyqësor; si dhe, ndër të tjera,**
- g) **çështjet që lidhen me aderimin në Bashkimin Evropian.**

Prandaj, efektet e mundshme që këto çështje mund të kenë në të ardhmen e gjyqësorit janë pasqyruar si faktorë edhe në këtë plan strategjik.

ELEMENTËT THELBËSOR TË PLANIT STRATEGJIK

Seksioni i mëposhtëm përshkruan elementët metodologjikë dhe komponentët thelbësorë të përdorur për hartimin e planit të ri strategjik të KLGG-së. Këto mjete i mundësuan KLGG-së të identifikonte qëllimet dhe objektivat kryesorë strategjike, duke përcaktuar gjithashtu hapat e veprimit, burimet dhe kohën e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave, si dhe mekanizmat për monitorimin e progresit. Në zhvillimin e secilit prej komponentëve të planit strategjik, KLGG-ja u mbështet në një rishikim të plotë të pikave të forta, mundësive, dobësive dhe kërcënimeve, si dhe në kontributin e grupeve të ndryshme të interesit.

Vizioni

Deklarata e vizionit sheh nga e ardhmja dhe ofron imazhin e gjendjes ideale që institucioni dëshiron të arrijë.

Vizioni duhet t'i frymëzojë njerëzit që TË ËNDËRROJNË.

Deklarata e Misionit

Një përshkrim i shkurtër dhe lehtësisht i kuptueshëm, zakonisht i formuluar në pak fjalë. Ajo përcakton qëllimin bazë të KLGJ-së dhe është në përputhje me vlerat, programet dhe veprimtaritë themelore të institucionit, të shprehura brenda kontekstit të gjerë të problemeve, nevojave dhe sfidave në rang kombëtar.

Misioni duhet t'i frymëzojë njerëzit që TË VEPROJNË.

Vlerat

Vlerat e një institucioni janë parimet e tij udhëheqëse, janë një kod sjelljeje, ose kod kulture, që shpjegon se si institucioni synon të funksionojë, në përputhje me këto vlera.

Deklarata e vlerave bën NJË PREMTIM.

Kaskada e Strategjisë

Kaskada e Strategjisë përfaqëson përgjigjet për pesë pyetjet thelbësore dhe të ndërlidhura mes tyre. Kjo qasje kërkon edhe ekselencë edhe llogaridhënie. Ajo i kërkon institucionit të jetë shumë i qartë lidhur me propozimin unik për vlerën që do të sjellë, pra, një deklaratë e qartë që përshkruan përfitimet që sjell puna e tij, mënyrën e përmbushjes së nevojave të palëve të interesit, si dhe çfarë e dallon institucionin nga të tjerët.

Synimet Strategjike

Formulime që shprehin rezultate të përgjithshme afatgjata që KLGJ-ja synon të arrijë në drejtim të funksioneve dhe veprimtarisë kryesore. Ato trajtojnë ndikimin e gjerë që KLGJ-ja dëshiron të arrijë.

Objektivat Strategjikë

Formulime që pasqyrojnë ndikimin specifik që KLGJ-ja synon të arrijë, në kuadër të një synimi të përcaktuar. Objektivat janë të lidhur me një grup synimesh dhe treguesish të performancës, që janë përcaktuar për ta ndihmuar Këshillin të monitorojë dhe kuptojë ecurinë.

Veprimtaritë

Formulime që përshkruajnë qasjet ose praktikatat që institucioni planifikon të ndjekë për të përparuar me objektivat.

Afati Kohor

Një përshkrim realist (e megjithatë ambicioz) i sasisë së kohës që nevojitet për përmbushjen e një objektiivi.

Partnerë të Jashtëm Kyç

Qeveria dhe agjenci private, organizata, partnerë për zhvillim (donatorë), apo subjekte që kontribuojnë për arritjen e objektivave të KLGJ-së.

Treguesit

Instrumente matëse të përgjithshme që tregojnë nëse arritja e rezultateve të dëshiruara është në drejtimin e duhur.

Matjet

Instrumente matëse që ndihmojnë në përcaktimin e ndikimit që kanë veprimtaritë mbi rezultatet. Me to lidhen disa pikësynime specifike dhe mund të jenë sasiore ose cilësore.

PLANI STRATEGJIK 2022-2024

VIZIONI

Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.

MISIONI

Misioni i KLGJ-së është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

VLERAT THEMELORE TË GJYOËSORIT

Pavarësia - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem gjyqësor që funksionon si një organ i pavarur, i pandikuar nga ndërhyrjet dhe i angazhuar ndaj sundimit të ligjit.

Integriteti - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem të ndershëm gjyqësor që vepron në përputhje me parimet më të larta morale dhe etike dhe që gjithmonë përpiqet të bëjë drejtësi.

Profesionalizmi - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem gjyqësor, anëtarët e të cilit i zotërojnë të gjitha aftësitë e nevojshme për të përmbushur më së miri rolin e tyre.

Paanshmëria - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të trajtojnë të gjithë qytetarët si të barabartë përpara ligjit.


Llogaridhënia - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të garantojnë që të gjithë anëtarët e gjyqësorit janë të gatshëm të marrin përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre.

Përveç vlerave themelore të KLGJ-së dhe gjykatave, vendimmarrja e përditshme në gjyqësorin shqiptar mbështetet edhe në parimet e rëndësishme në vijim:

Akresi, Efektshmëria, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Trajtimi i Drejtë, Besueshmëria, Respekti, Përgjegjshmëria dhe Transparenca.

Rrjedha (Kaskada) e Strategjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor të Shqipërisë

VIZIONI i KLGJ-së: Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.



ANALIZA SWOT

Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet

Gjatë procesit të planifikimit strategjik, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e institucionit (përmes një analize SWOT). Ky proces siguroi informacion me vlerë, lidhur me çështjet aktuale dhe të mundshme, që mund të prekin KLGJ-në dhe gjyqësorin. Analiza SWOT i erdhi në ndihmë Këshillit të kuptojë më mirë kontekstin mjedisor, ndërkohë që anëtarët po marrin rolin e tyre si drejtues të gjyqësorit në Shqipëri. Kjo analizë SWOT paraqet edhe disa mësimet të rëndësishme të nxjerra gjatë periudhës së planifikimit të parë strategjik të Këshillit.



SYNIMET STRATEGJIKE 2022 -2024

Gjatë tre viteve të ardhshme, gjyqësori do t'i përqendrojë përpjekjet e tij në pesë synime strategjike parësore të cilat përputhen me vizionin, misionin, vlerat dhe kaskadën e strategjisë, të përcaktuar më lart.

Synimet dhe objektivat e përcaktuar në këtë plan janë ambicioze dhe dëshmojnë qartësisht që KLGJ po hyn tashmë në një fazë më të konsoliduar, qasje që do të drejtojë qëllimet e gjyqësorit deri në fund të vitit 2024.

Në planin e veprimit që shoqëron këtë dokument, KLGJ-ja planifikon të përdorë një sërë treguesish për matjen e performancës, të cilat shërbejnë për të vlerësuar ecurinë drejt secilit synim, si dhe drejt objektivave e strategjive të lidhura me to. Matjet e performancës do të monitorohen dhe përditësohen bazuar në zhvillimin e objektivave dhe shkallën e realizimit të tyre brenda afatit kohor të përcaktuar. Informacioni apo të dhënat sasiore dhe cilësore, do të mbledhen, shqyrtohen dhe analizohen me qëllim për të kuptuar më mirë impaktin e zbatimit të këtij plani në përmbushjen e synimeve madhore të KLGJ-së për sistemin gjyqësor në vend.

KLGJ-ja beson se, gjatë tre viteve të ardhshme, është e rëndësishme të tregojë vendosmëri për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të gjitha nivelet. Pesë synimet e mëposhtme janë hartuar me qëllim trajtimin e fushave me problematikat më urgjente.

SYNIMET STRATEGJIKE TË REFORMËS GJYQËSORE



SYNIMET PËR KAPACITETET DHE MENAXHIMIN

SYNIMI 1: Përshpejtimi i Zbatimit të Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve

Sigurimi i burimeve të përshtatshme për zbatimin e reformave të pushtetit gjyqësor, përfshirë infrastrukturën dhe personelin gjyqësor, sa më shpejt të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi cilësisë.

KLJGJ-ja është e vetëdijshme se pas vitesh mosfunksionimi të duhur të sistemit gjyqësor dhe me një Gjykatë të Lartë jofunksionale, duhet punuar pa u lodhur për t'i trajtuar këto çështje si prioritetet më urgjente të gjyqësorit.

SYNIMI 2: Zbatimi dhe Monitorimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore

Angazhimi për zbatimin e praktikave më të mira për menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duke u përqendruar në standardet që sigurojnë cilësi gjyqësore.

KLJGJ-ja është e vetëdijshme se në të shkuarën, fjala ekselencë nuk mund të përdorej shpesh për të përshkruar gjyqësorin shqiptar. Ndërkohë që progresi vazhdon, KLJGJ-ja angazhohet të sigurojë që gjyqësori të ketë personel që përmbush standarde rigoroze etike, me njohuri të thella në legjislacionin shqiptar dhe që vlerësohet bazuar në standardet më të larta profesionale.

SYNIMI 3: Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funkcionimi më i Mirë i Gjykatave

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes miratimit dhe zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale.

KLJGJ-ja është në njohje të situatës dhe ku infrastruktura gjyqësore (ndërtesat dhe mjediset e punës) e sistemet e teknologjisë së informacionit janë vjetëruar dhe janë shpesh jofunksionale. KLJGJ-ja angazhohet të marrë hapat e nevojshëm për të ngritur dhe mirëmbajtur një sistem të sigurt, funksional, efikas dhe të mirëadministruar të teknologjisë së informacionit.

SYNIMI 4: Fuqizimi i Kapaciteteve të Brendshme të KLJGJ-së

Përcaktimi i qartë i rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe administratës së tij dhe dhënia përparësi fuqizimit institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë, përfshirë kërkimin e burimeve të përshtatshme buxhetore.

KLJGJ-ja zotohet të konsolidojë themelet e punës së saj dhe të vazhdojë një ndërtim të sigurt “të godinës” së drejtësisë shqiptare. Kjo lidhet me krijimin e strukturave dhe me plotësimin me personel që pasqyron vlerat e institucionit, përfshirë këtu një administratë të përbërë nga specialistët më të talentuar dhe të palodhur në administrimin e gjykatave.

SYNIMI 5: Zbatimi dhe Përmirësimi i Strategjive për Komunikimin e Jashtëm

Përmirësimi i ndërveprimit midis gjyqësorit, partnerëve tanë dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi.

KLJGJ-ja zotohet të veprojë me transparencë duke siguruar që si individët, ashtu edhe shoqëria të jenë plotësisht të informuar mbi ndryshimet në gjyqësor.

<p>SYNIMI 1: <i>Përsheptimi i Zbatimit të Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve</i></p>	<p>1.1 Rivënia në funksionim të plotë e Gjykatës së Lartë.</p> <p>1.2 Përfundimi i raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit.</p> <p>1.3 Adresimi i nevojave infrastrukturore dhe administrative (burimeve njerëzore) në të gjitha gjykatat.</p> <p>1.4 Reduktimi numrit të çështjeve të prapambetura për sistemin gjyqësor</p> <p>1.5 Plotësimi i kuadrit nënligjor sipas përcaktimeve të paketës së ligjeve të reformës në drejtësi.</p>
<p>SYNIMI 2: <i>Zbatimi dhe Monitorimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore</i></p>	<p>2.1 Përcaktimi i standardeve për ekselencë gjyqësore dhe miratimi i akteve të nevojshme nënligjore.</p> <p>2.2 Rritja e performancës së trupës (gjyqtarëve) dhe administratës gjyqësore përmes vlerësimit periodik të veprimtarisë profesionale në përputhje me afatet dhe kuadrin e ri ligjor të miratuar.</p> <p>2.3 Ngritja e mekanizmave monitorues për zbatimin e etikës profesionale nga gjyqtarët, si dhe miratimi i Kodit të Etikës për personelin e administratës së gjykatave.</p>
<p>SYNIMI 3: <i>Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funksionimi më i Mirë i Gjykatave</i></p>	<p>3.1 Përfundimi i procesit të përcaktimit të një Harte të Re Gjyqësore, përmes rritjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë.</p> <p>3.2 Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore</p>

	<p>për të përmbushur standardet bashkëkohore.</p> <p>3.3 Mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemi elektronik të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.</p> <p>3.4 Vënia në funksionim të plotë e Qendrës së TI-së të sistemit të Drejtësisë.</p> <p>3.5 Përmirësimi i funksionimit të gjykatave në të gjitha shkallët, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave.</p> <p>3.6 Përmirësimi i kapaciteteve organizative të KLGJ-së dhe gjykatave për t'iu përgjigjur situatave të krizave dhe për të ruajtur funksionalitetin në masën më të madhe të mundshme.</p> <p>3.7 Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga administrata e gjykatës përmes digjitalizimit.</p>
<p style="text-align: center;">SYNIMI 4: <i>Fuqizimi i Kapaciteteve të Brendshme të KLGJ-së</i></p>	<p>4.1 Rritja e kapaciteteve të KLGJ-së për të përballuar me sukses sfidat e sistemit gjyqësor.</p> <p>4.2 Forcimi i kulturës novatore në qeverisjen e sistemit gjyqësor duke marrë në konsideratë zhvillimet dhe sfidat.</p> <p>4.3 Përmirësimi dhe institucionalizimi (nëpërmjet ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës, nënshkrimit të MoU, etj) i bashkëpunimit të KLGJ-së me institucione apo organizata të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>4.4 Fuqizimi/ Rritja e vazhdueshme e rolit të KLGJ-së në hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit që prek punën e gjyqësorit.</p>
<p style="text-align: center;">SYNIMI 5: <i>Zbatimi dhe Përmirësimi Strategjive për Komunikimin e Jashtëm</i></p>	<p>5.1 Rritja e transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.</p> <p>5.2 Përmirësimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe me mediat për të siguruar një marrëdhënie proaktive, transparente e informuese.</p>

5.3 Fuqizimi i ndërveprimit të KLGJ-së me gjykatat për zbatimin e planit strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor miratuar nga KLGJ.

MONITORIMI, LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Struktura dhe Qasja

Në hartimin e këtij plani strategjik për të gjithë sistemin gjyqësor në Shqipëri, Këshilli njih rëndësinë që ka zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i kujdesshëm i veprimtarive të tij. Në përpjekjen për të prioritzuar këto veprimtari, strukturat e posaçme të Këshillit do të monitorojnë në vazhdimësi ecurinë, rishikojnë drejtimin strategjik, dhe zbatimin e vetë strategjisë. Struktura do të mbledhë të dhëna dhe informacione të rëndësishme në lidhje me zbatimin e strategjisë dhe kur është e mundur, sugjeron ndryshime në strategji, tregues dhe/ose instrumente matëse.

Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë është një strukturë e përkohshme dhe me anëtarësi fluide, e cila caktohet në bazë të nevojave të Këshillit për mbikëqyrje. Duke qenë se objektivat dhe masat përkatëse mund të ndryshojnë në kohë, përbërja e kësaj strukture duhet të jetë e ndryshueshme.

Kërkesat për Raportim

Struktura e KLGJ-së për monitorimin e zbatimit të strategjisë është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave strategjike.

Ky proces e pajis Këshillin me një instrument për monitorimin dhe kontrollimin e vetë sistemeve të brendshme, proceseve dhe progresit në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të parashtruar në planin strategjik.

Struktura monitoruese është përgjegjëse për hartimin e raporteve të punës tremujore deri në përfundim të afatit të kësaj strategjie. Këto raporte ofrojnë një tablo të qartë të ecurisë së Këshillit në zbatimin e strategjisë, si dhe në përqendrimin e vëmendjes në ato çështje që mund ta pengojnë zbatimin e saj.

Në funksion të matjes së rezultateve, struktura e monitorimit të strategjisë do të hartojë dy herë në vit (çdo gjashtë muaj) një matricë vlerësimi që shpjegon më tej progresin në zbatimin e strategjisë, apo, sipas rastit, arsyet për devijimin nga plani i miratuar i veprimit. Matësit e përdorur gjatë procesit të planifikimit pasqyrojnë mësimet e rëndësishme që Këshilli nxori gjatë periudhës së planifikimit fillestar.

Duhet vënë në dukje se Këshilli i kushtoi një vëmendje të madhe zhvillimit të treguesve

specifikë sasiorë dhe cilësorë për secilin zë të planit strategjik dhe të planit të veprimit. Shumë prej këtyre treguesve pasqyrojnë qëllimisht treguesit e parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe kurdo të jetë e mundur, kanë si qëllim bashkërendimin e punës së Gjyqësorit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Këto tregues do të drejtojnë strukturën e monitorimit për matjen e progresit gjatë procesit të vlerësimit dhe monitorimit.

Akresi te të Dhënat e Monitorimit dhe Vlerësimit

Struktura e monitorimit është përgjegjëse për dorëzimin e të gjitha raporteve për rishikim dhe miratim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Të gjitha raportet publikohen në faqen zyrtare të Këshillit në internet.

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit është përgjegjës për rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo vit për të garantuar përputhshmërinë gjatë punës me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Shtojca A: Pjesëmarrësit në Procesin e Planifikimit Strategjik

Hartimi i këtij Plani Strategjik nuk do të kishte qenë i mundur pa angazhimin e jashtëzakonshëm të një grupi të ndërthurur pjesëmarrësish dhe të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Naureda Llagami, Kryetare
Maksim Qoku, Zëvendës Kryetar
Alban Toro
Brikena Ukperaj
Irena Plaku
Dritan Hallunaj
Erjon Muharremaj
Fatmira Luli
Ridvan Hado
Marcela Shehu
Klodian Kurushi

Këshilli dhe stafi i tij administrativ vlerësojnë kontributin dhe asistencën që anëtarët e gjyqësorit, të cilët përfaqësonin të gjitha instancat e gjykatave, ato të juridiksionit të përgjithshëm, administrativ dhe të posaçme, dhanë gjatë hartimit të këtij plani.

**KËSHILLI I LARTË
GJYQËSOR**

WWW.KLGJ.AL

